REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË

MARS 2021

# EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

# EKONOMIA DHE BUXHETI

## Raport Mujor

## Mars 2021

© Ministria e Financave dhe Ekonomisë, 2021
Drejtoria e Analizave Makroekonomike dhe Statistikave
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 3, Tiranë

www.financa.gov.al

**E-mail:** **Juli.Lubonja@financa.gov.al**

# Përmbajtja

**VEÇORITË KRYESORE** ____ **2**

**ZHVILLIMET EKONOMIKE** ____ **3**

1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit ____ 3
2. Kursi mesatar i Këmbimit ____ 4
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave ____ 5
4. Bilanci i Pagesave ____ 6
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar____ 7
6. Kredia për Ekonominë ____ 8
7. Oferta e Parasë ____ 9
8. Depozitat sipas burimeve____ 10

**SEKTORI FISKAL** ____ **11**

1. Buxheti i Konsoliduar ____ 11
2. Të Ardhurat Sipas Burimeve ____ 12
3. Financimi i Bilancit Fiskal ____ 13

**ANEKSI STATISTIKOR** ____ **13**

# Veçoritë Kryesore

- Indeksi i çmimeve të konsumit në muajin Mars 2021, arriti në 103.0;
- Norma vjetore e inflacionit për muajin Mars 2021 ishte 1.2 përqind;
- Kursi mesatar i këmbimit të monedhës vendase me dy monedhat kryesore të huaja për muajin Mars 2021 ishte 103.61 lekë për dollarë dhe 123.34 lekë për euro;
- Normat e interesit të depozitave në lekë gjatë muajit Mars 2021 shënuan kuotën 0.45 përqind për ato 12–mujore; 0.34 përqind për depozitat 6-mujore; 0.16 përqind për depozitat 3-mujore dhe 0.40 përqind për depozitat 1-mujore;
- Normat e interesit për huatë në lekë ishin 5.35 përqind për huatë 12-mujore dhe 5.84 përqind për ato 6-mujore;
- Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në rreth 1.469.039 milionë lekë në muajin Mars, duke shënuar një rritje prej rreth 7.58 përqind, krahasuar me një vit më parë;
- Bilanci i përgjithshëm i pagesave për tremujorin e katërt të 2020-ës rezultoi me rënie të mjeteve valutore (rezervës), duke shënuar vlerën -142.7 milionë euro.
- Situata Buxhetore për periudhën Janar-Mars 2021 rezultoi me një deficit të përgjithshëm prej rreth -7.16 miliardë lekë, ndërkohë që ishte planifikuar një deficit prej -13.49 miliardë lekë.
- Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën Janar-Mars 2021, arritën në rreth 108.591 miliardë lekë ose afërsisht 1.5% më shumë se plani për këtë periudhë.
- Shpenzimet gjithsej gjatë së njëjtës periudhë, arritën në rreth 115.753 miliardë lekë ose rreth 4% më pak se shpenzimet e planifikuara për këtë periudhë.

# Zhvillimet Ekonomike

## 1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Inflacioni vjetor për muajin Mars 2021 ishte 1.2%. Ndërkohë, një vit më parë ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit ishte 2.1%. Ndryshimi mujor i indeksit të çmimeve të konsumit në muajin Mars 2021, krahasuar me Shkurt 2021 është 0.7%. Një muaj më parë, Shkurt 2021, IÇK shënoi rritje mujore prej 1.1%.

Referuar një viti më parë, Indeksi i Çmimeve të Konsumit për muajin Mars 2020 shënoi rritje mujore prej 0.6%, në krahasim me muajin paraardhës.

Fig-1




*Ndryshimet mujore të IÇK-së*

Burimi: INSTAT

Nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit, grupet të cilat patën kontributin më të lartë në inflacionin e përgjithshëm ishin:

- "Ushqime dhe pije joalkolike" me rritje vjetore të çmimit prej +3.1%, duke kontribuar me +0.96 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +1.2%.
- "Mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë" me rritje vjetore të çmimit prej +2.2%, duke kontribuar me +0.15 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +1.2%.
- "Pije alkolike dhe duhan" me rritje vjetore të çmimit prej +1.3%, duke kontribuar me +0.05 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +1.2%.

Nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit, kategoritë të cilat kanë ndikuar negativisht në inflacionin e përgjithshëm përgjatë muajit Mars 2021 ishin:

- "Transport" ka pësuar rënie vjetore të çmimit prej -1.6%, duke kontribuar me -0.1 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +1.2%.

Tab - 1 *Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)*

| *VITI* | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Nëntor | Dhjetor |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2020 | 1.5 | 1.2 | **2.1** | 1.9 | 2.1 | 1.8 | 1.4 | 1.3 | 1.5 | 2.0 | 1.6 | 1.1 |
| 2021 | 0.4 | 1.1 | **1.2** | - | - | - | - | - | - | - | - | - |

*Burimi: INSTAT*

## 2. Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt euros në muajin Mars 2021, arriti në 123.34 lekë/euro, duke shënuar rënie në vlerë me 0.22 përqind krahasuar me një muaj më parë. Në fund të muajit Mars, një euro u këmbye me 123.16 lekë.

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin Mars 2021 arriti në 103.61 lekë/dollarë duke shënuar rritje në vlerë me 1.36 përqind kundrejt një muaji më parë. Në fund të muajit Mars, kursi i këmbimit për dollarin amerikan arriti në nivelin 104.91 lekë/dollarë.

Fig-2




Ecuria e kursit të këmbimit Mars 2021

Burimi: Banka e Shqipërisë

Në krahasim me muajin Mars të vitit të kaluar, pas një periudhe të konsiderueshme forcimi, rezulton se monedha shqiptare ka pësuar një mbiçmim ndaj monedhës europiane në masën 0.79 përqind, ndërsa kundrejt dollarit amerikan rezulton se është mbiçmuar në masën 7.56 përqind. Në pëgjithësi, dobësimi i lekut në vitin e fundit ka ardhur si pasojë e një rënie relative të ekonomisë në vend, për shkak të dy goditjeve të njëpasnjëshme, tërmetit të ndodhur në dhjetor 2019 dhe situatës së krijuar nga pandemia botërore Covid-19.

Kursi i këmbimit të euros me dollarin amerikan, shënoi një nivel mesatare rreth 0.84 dollarë/euro për muajin Mars 2021.

Ndër faktorët e brendshëm që kanë ndikuar në ecurinë e monedhës vendase gjatë kësaj periudhe përmendim: qendrueshmëria e kursit të këmbimit për shkak të ndërhyrjes së shpejtë të BSH-së, stabiliteti i situatës makroekonomike në vend, efikasiteti i politikës fiskale, efikasiteti në politikën monetare dhe në operacionet ndërbankare të ndërmarra nga BSH-ja, etj.

## 3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave

Gjatë muajit Mars 2021, normat e interesit të depozitave me afat 12 dhe 1 mujore shënuan vlerat më të larta prej 0.45 dhe 0.40 përqind përkatësisht, pasuar nga ato me afat 6 dhe 3 mujore që arritën kuotën 0.34 dhe 0.16 përqind përkatësisht.

Krahasuar me një muaj më parë, normat e interesit të depozitave me afat maturimi 6 dhe 3 mujore kanë shënuar rritje mujore prej përkatësisht 0.05 dhe 0.01 pikë përqindje. Ndërsa normat e interesit të depozitave me afat 12 mujore shënuan rënie mujore prej 0.18, ndërkohë ato me afat 1 muaj nuk patën ndryshim.

Fig. 3




*Normat e interesit për depozitat (%)*

Burimi: Banka e Shqipërisë

Referuar një viti më parë, normat e interesit të depozitave me afat maturimi 1, 3 dhe 6 mujore kanë shënuar rënie vjetore përkatësisht prej 0.3, 0.01 dhe 0.01 pikë përqindje. Ndërsa normat e interesit të depozitave me afat 12 mujore shënuan rritje vjetore përkatësisht me 0.01 pikë përqindje.

Normat e Interesit të huave 6 dhe 12 mujore, gjatë muajit Mars 2021, arritën përkatësisht kuotën prej 5.84 dhe 5.35 përqind. Në krahasim me një muaj më parë, normat e interesit të huave 12 mujore kanë shënuar rënie me 1.21 pikë përqindje. Ndërsa, ato 6 mujore rritje me 0.45 pikë përqindje. Krahasuar me një vit më parë normat e interesit të huave 6 dhe 12 mujore kanë shënuar rënie vjetore përkatësisht me 0.91 dhe 1.21 pikë përqindje.

Fig-4




**Normat e interesit për huatë dhe bonot**

Burimi: Banka e Shqipërisë

Normat e interesit të bonove të thesarit 12 mujore për muajin Mars 2021 patën rritje mujore dhe vjetore përkatësisht me 0.07 dhe 0.15 pikë përqindje.

# 4. Bilanci i Pagesave

Në tremujorin e katërt të vitit 2020, bilanci i përgjithshëm i pagesave rezultoi negativ në rënie të mjeteve valutore (rezervës) prej rreth 143 milionë euro. Deficiti i llogarisë korrente vlerësohet në rreth 352 milionë euro, i zgjeruar në terma vjeto-rë me rreth 6 milionë euro (ose 2%). Thellimi i deficitit korrent, është diktuar nga zgjerimi i deficitit tregtar në mallra dhe bal-ancës negative të të ardhurave parësore. Kjo ecuri është kompensuar pjesërisht nga zgjerimi i suficitit në shërbime dhe rritja e balancës pozitive në të ardhurat dytësore. Për tremujorin e katërt 2020, shkalla e ekspozimit të ekonomisë shqiptare vlerësohet në 296 milionë euro, në rënie me 23 milionë euro referuar nivelit në një vit më parë. Flukset hyrëse në llogarinë kapitale dhe financiare (përfshirë mjetet e rezervës) shënojnë 239 milionë euro dhe mundësojnë mbulimin e deficitit korrent në masën 68%.

Fig-5




Bilanci i Pagesave T4 - 2020

Burimi: Banka e Shqipërisë

Në tremujorin e katërt 2020:

- Deficiti i llogarisë korrente vlerësohet në rreth 352 milionë euro, i thelluar në terma vjetorë;
- Llogaria e shërbimeve vlerësohet në një balancë pozitive prej rreth 303 mil-ionë euro, me rritje në ter-ma vjetorë;
- Fluksi i investimeve të huaja direkte, në formën e zgjerimit të kapitalit vlerësohet në 257 milionë euro;
- Të ardhurat në formën e prurjeve valutore nga emi-grantët shënuan 203 mil-ionë euro;

Fig-6




Llogaria Korente T4 - 2020

Burimi: Banka e Shqipërisë

## 5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar

Gjatë muajit Mars 2021, sistemi bankar ka shënuar rritje të mjeteve valutore neto (M.V.N), me rreth 43.237 milionë lekë krahasuar me muajin Mars të vitit 2020. Kjo rritje ka ardhur kryesisht si pasojë e rritjes së mjeteve valutore neto të bankës qendrore me 65.559 milionë lekë. Krahasuar me një muaj më parë mjetet valutore neto kanë shënuar rritje me 23.198 milionë lekë, ku më së shumti ka kontribuar rritja mujore prej 25.422 milionë lekë e Bankës Qëndrore.

Fig-7




Ecuria e M.V.N. të sistemit Mars'20 - Mars'21

Burimi: Banka e Shqipërisë

Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në rreth 1.469.039 milionë lekë në muajin Mars 2021, duke shënuar një rritje prej rreth 103.473 milionë lekë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, pra një rritje vjetore prej 7.58 përqind.

Gjithashtu në muajin Mars 2021, sistemi bankar rezulton me rritje mujore prej 7,526 milionë lekë ose 0.51 përqind në mjetet valutore neto krahasuar me muajin paraardhës.

Fig-8




Agregati M3 Mars '20 - Mars '21

Burimi: Banka e Shqipërisë

# 6. Kredia për Ekonominë

Totali i kredisë për ekonominë për muajin Mars 2021 arriti në rreth 610.654 milionë lekë. Bilanci i kredisë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, shënoi rritje me vlerë 13.093 milionë lekë, ose rritje me rreth 2.2 përqind. Struktura e kredisë sipas monedhave është e balancuar mes monedhës kombëtare (53%) dhe monedhave të huaja (47%).

Fig-9




*Rritja e stokut total të kredive*

Burimi: Banka e Shqipërisë

Gjatë muajit Mars 2021, zëri “Korporata të tjera jo-financiare”, zuri peshën më të lartë të totalit të kredive, me rreth 61 përqind ose 372.662 milionë lekë, ndjekur nga kreditë për individë, ku pesha e tyre specifike arriti në nivelin 34.81 përqind ose rreth 212.557 milionë lekë. Zërat “Korporata jo financiare publike” dhe “Korporata të tjera financiare” arritën respektivisht 1.92 dhe 2.2 përqind apo 11.747 dhe 13.291 milionë lekë.

Fig-10




*Përberja e kredive Mars '21*

Burimi: Banka e Shqipërisë

Për sa i përket shpërndarjes së kredisë sipas monedhës së huaj për muajin Mars 2021, zëri “Koorporata të tjera jofinanciare” zuri peshën më të lartë të kredive, me rreth 72.55 përqind, ndjekur nga “Sektorë të tjerë rezidentë” me rreth 25.57 përqind. “Koorporata të tjera financiare” dhe “Koorporata jofinanciare publike” kontriubojnë përkatësisht me 2.1 dhe 0.8 përqind secili.

# 7. Oferta e Parasë

Paraja jashtë Korporatave Depozituese arriti në rreth 347.728 milionë lekë në fund të muajit Mars 2021. Raporti i Parasë jashtë Bankave me M3 në Mars 2021 ka shënuar rritje mujore prej 0.01 përqind dhe rritje vjetore prej 2.16 përqind, duke arritur nivelin 23.7 përqind. Raporti i Parasë jashtë Bankave me Depozitat ka shënuar rritje mujore prej 0.02 përqind, dhe rritje vjetore prej 3.61 përqind, duke shënuar nivelin 31 përqind.

Fig-11




***Raporte të parasë jashtë bankave me M3 &***

Burimi: Banka e Shqipërisë

Depozitat në valutë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare për muajin Mars 2021, kanë shënuar rritje vjetore prej 4.552 milionë lekë, e sjellë kryesisht nga depozitat për individë, të cilat kanë përbërë rreth 79.1 përqind të depozitave në valutë. Gjithashtu depozitat në Lekë gjatë muajit Mars 2021 shënuan rritje prej 44.491 milionë lekë në krahasim me muajin Mars 2020. Sektori i Individëve në lekë ka zënë rreth 81.3 përqind të tyre.

Fig-12




**Raporti i Depozitave ndaj M3**

Burimi: Banka e Shqipërisë

# 8. Depozitat sipas Burimeve

Gjatë muajit Mars 2021, zëri "Sektorë të tjerë rezidentë" zuri nivelin më të lartë të depozitave të transferueshme në lekë, me rreth 81.1 përqind, ndjekur nga "Koorporata të tjera jofinanciare", me rreth 13.8 përqind dhe nga "Koorporata jo-financiare publike" me 2.9 përqind. "Sektorë të tjerë rezidentë" dhe "Koorporata të tjera jofinanciare" ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 79.1 përqind dhe rreth 18.1 përqind. "Sektorë të tjerë rezidentë" ishin dukshëm burimi më i rëndësishëm i depozitave totale me rreth 80.1 përqind e totalit.

Fig-13




Rritja e stokut total të depozitave

Burimi: Banka e Shqipërisë

Në total, "Sektorë të tjerë rezidentë" përbëjnë pjesën më të madhe me rreth 898.610 milionë lekë të depozitave totale. Ato ndiqen nga "Koorporata të tjera jofinanciare" (181.002 milionë lekë), "Koorporata të tjera financiare" (21.947 milionë lekë), dhe "Koorporata jofinanciare publike" (19.222 milionë lekë). "Qeveria lokale" kontribuoi me rreth (1.732 milionë lekë) në totalin e depozitave. Gjatë muajit Mars 2021, niveli i përgjithshëm i depozitave arriti vlerën rreth 1.122.513 milionë lekë.

Fig-14




Përberja e depozitave Mars '21

Burimi: Banka e Shqipërisë

Krahasuar me një muaj më parë niveli i depozitave shënoi rritje prej rreth 5.576 milionë lekë, gjithashtu krahasuar me një vit më parë totali i depozitave ka shënuar rritje me 49.463 milionë lekë.

# Sektori Fiskal

## 1. Buxheti i Konsoliduar

Për periudhën Janar - Mars 2021 janë mbledhur rreth 108.591 miliardë lekë të ardhura, përkundrejt shpenzimeve të përgjithshme prej 115.753 miliardë lekë, ku pjesa më e madhe përfshin 101.341 miliardë lekë në shpenzime korrente dhe rreth 11.269 miliardë lekë në shpenzime kapitale, nga të cilat rreth 31.5% janë financime të huaja.

Fig - 15




*Treguesit Fiskal, Mars 2021*

Burimi: Ministria e Financave

Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Doganave është rreth 72.787 miliardë lekë (ose rreth 0.1% me pak se plani i periudhës). Të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor janë rreth 4.920 miliardë lekë (ose rreth 6.1% më shumë se plani i periudhës). Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore 26.284 miliardë lekë (ose rreth 8% më shumë se plani i periudhës) dhe të ardhurat jo-tatimore në nivelin 4.199 miliardë lekë (ose rreth 18.8% më pak se plani për periudhën Janar-Mars 2021).

Nga totali i shpenzimeve korrente prej 101.341 miliardë lekë, 20.188 miliardë lekë (20% e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, rreth 9.671 miliardë lekë (9.5%) për shpenzime interesi, 10.486 miliardë leke (10.3%) për shpenzime operative dhe mirëmbajtje, 255 miliardë lekë (0.3%) për subvencione, 43.367 miliardë lekë (42.7%) për shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, 10.754 miliardë lekë (10.6%) për shpenzimet e qeverisjes vendore, dhe 6.619 miliardë lekë (6.5%) për shpenzimet e tjera. Shpenzimet kapitale u financuan 31.5% me financim të huaj.

## 2. Të ardhurat sipas burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën Janar - Mars 2021 ishin rreth 108.591 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore rreth 103.991 miliardë lekë, të ardhurat jo-tatimore në rreth 4.199 miliardë lekë.

**Tab - 2**

**Të ardhurat gjatë muajit Janar-Mars 2021 (mld Lekë)**
**Revenues during January-March 2021 (in billion ALL)**

| Burimi (Source) | Mars '21 March '21 | Mars '20 March '20 | Ndrysh(%) Chang (%) |
|---|---|---|---|
| TVSH (VAT) | 31.74 | 31.85 | -0.3 |
| Taksa doganore (Custom Tax) | 1.5 | 1.36 | +10.8 |
| Akcizat (Excise) | 10.35 | 10.22 | +1.3 |
| Tatimi mbi fitimin (Profit Tax) | 10.58 | 9.09 | +16.4 |
| Tatim mbi të ardhurat personale (TAP) / (Income Tax) | 9.3 | 8.46 | +10.0 |
| Taksat nacionale (National Tax) | 9.31 | 8.27 | +12.5 |

*Burimi: Ministria e Financave, Statistikat Fiskale: Mars - 2021*

*Source: Ministry of Finance, Fiscal Statistics: March - 2021*

## 3. Financimi i Bilancit Fiskal

Deficiti prej 7.16 miliardë lekë gjatë periudhës Janar-Mars 2021, u financua nga zëri financim i huaj.

Për periudhën Janar-Mars 2021, disa nga treguesit kryesorë fiskalë ishin:

• Realizimi i të ardhurave në masën 108.591 miliardë lekë,

• Realizimi i shpenzimeve në masën 115.753 miliardë lekë.

Në realizimin e të ardhurave për periudhën Janar-Mars 2021, kontributin kryesor e kanë dhënë të ardhurat tatimore, të cilat arrijnë shifrën e 103.991 miliardë lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë periudhë, peshën me të lartë e zënë shpenzimet korrente me 101.341 miliardë lekë dhe shpenzimet për fonde speciale me rreth 43.367 miliardë lekë

# Aneksi Statistikor

Tab - 1 **Indeksi i çmimeve të konsumit**
*Consumer price index (in %)*

| | Mujor (Monthly) | | | | | | Mesatar Mujor (Monthly Average) | | | | | | Vjetor (Annual) | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Muaji** | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | **2021** | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | **2021** | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | **2021** | **Month** |
| **Janar** | 0.9 | 1.5 | 1.5 | 1.6 | 1.9 | 1.3 | 0.9 | 1.5 | 1.5 | 1.6 | 1.9 | 1.3 | 1.5 | 2.8 | 1.7 | 1.9 | 1.5 | 0.4 | **January** |
| Shkurt | 1.1 | 0.5 | 0.8 | 0.6 | 0.4 | 1.1 | 1.0 | 1.0 | 1.1 | 1.1 | 1.1 | 1.2 | 0.2 | 2.2 | 2.1 | 1.7 | 1.2 | 1.1 | February |
| Mars | 0.5 | 0.4 | 0.3 | -0.3 | 0.6 | **0.7** | 0.8 | 0.8 | 0.9 | 0.6 | 0.9 | **1.0** | 0.3 | 2.1 | 2.0 | 1.1 | 2.1 | **1.2** | March |
| Prill | -0.4 | -0.6 | -0.5 | -0.2 | -0.4 | | 0.5 | 0.5 | 0.5 | 0.4 | 0.6 | | 0.3 | 1.9 | 2.1 | 1.4 | 1.9 | | April |
| Maj | -1.2 | -1.2 | -1.2 | -1.0 | -0.8 | | 0.2 | 0.1 | 0.2 | 0.1 | 0.3 | | 0.7 | 2.0 | 2.1 | 1.5 | 2.1 | | May |
| Qershor | -0.6 | -0.4 | -0.1 | -0.3 | -0.6 | | 0.04 | 0.0 | 0.1 | 0.1 | 0.2 | | 1.2 | 2.2 | 2.4 | 1.3 | 1.8 | | June |
| Korrik | 0.0 | -0.1 | -0.3 | -0.1 | -0.5 | | 0.04 | 0.0 | 0.1 | 0.0 | 0.1 | | 1.9 | 2.0 | 2.3 | 1.5 | 1.4 | | July |
| Gusht | 0.9 | 0.4 | 0.4 | 0.3 | 0.2 | | 0.14 | 0.1 | 0.1 | 0.1 | 0.1 | | 2.0 | 1.6 | 2.2 | 1.5 | 1.3 | | August |
| Shtator | 0.4 | 0.4 | 0.2 | 0.1 | 0.4 | | 0.17 | 0.1 | 0.1 | 0.1 | 0.1 | | 1.8 | 1.6 | 2.1 | 1.3 | 1.5 | | September |
| Tetor | -0.2 | 0.0 | -0.2 | -0.2 | 0.2 | | 0.04 | -0.1 | -0.1 | -0.1 | 0.1 | | 1.8 | 1.6 | 2.1 | 1.3 | 2.0 | | October |
| Nëntor | 0.1 | -0.1 | -0.2 | -0.2 | -0.5 | | 0.12 | 0.1 | 0.1 | 0.0 | 0.1 | | 1.9 | 1.7 | 1.8 | 1.4 | 1.6 | | November |
| Dhjetor | 0.1 | -0.1 | -0.2 | -0.2 | 0.3 | | 0.05 | -0.1 | -0.1 | -0.1 | 0.1 | | 1.9 | 1.7 | 1.8 | 1.4 | 1.1 | | December |

**Burimi** *: INSTAT* **Source** *: INSTAT*

Tab - 2 **Kursi i këmbimit**

*Exchange rate*

| Monedha | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 Janar January | 2021 Shkurt February | 2021 Mars March | Currency |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *Mesatarja e periudhës* | | | | | | | | | | *Average of period* |
| USD | 125.96 | 124.15 | 119.10 | 107.99 | 109.85 | 108.65 | 101.61 | 102.22 | 103.61 | USD |
| EURO | 139.74 | 137.36 | 134.15 | 127.59 | 123.01 | 123.77 | 123.53 | 123.61 | 123.34 | EURO |
| *Fundi i periudhës* | | | | | | | | | | *In the end of period* |
| USD | 125.79 | 128.17 | 111.10 | 107.82 | 108.64 | 100.84 | 101.97 | 101.99 | 104.91 | USD |
| EURO | 137.28 | 135.23 | 132.95 | 123.42 | 121.77 | 123.70 | 123.61 | 123.67 | 123.16 | EURO |

***Burimi** : Banka e Shqipërisë* — ***Source** : Bank of Albania*

Tab - 3 **Normat e interesit me bazë vjetore (në Lek)**
*Annual Interest Rates (in ALL)*

| Në përqindje | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 Janar January | 2021 Shkurt February | 2021 Mars March | In percent |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *Norma e depozitave* | | | | | | | *Deposits rates* |
| 12-M | 0.73 | 0.49 | 0.41 | 0.47 | 0.63 | 0.45 | 12-M |
| 6-M | 0.59 | 0.42 | 0.35 | 0.32 | 0.29 | 0.34 | 6-M |
| 3-M | 0.28 | 0.23 | 0.21 | 0.15 | 0.15 | 0.16 | 3-M |
| 1-M | 0.76 | 0.66 | 0.49 | 0.41 | 0.40 | 0.40 | 1-M |
| *Norma e huasë* | | | | | | | *Lending rates* |
| 12-M | 5.66 | 6.25 | 6.05 | 6.85 | 6.56 | 5.35 | 12-M |
| 6-M | 8.12 | 7.07 | 6.28 | 5.56 | 5.39 | 5.84 | 6-M |
| *Norma e letrave me vlerë* | | | | | | | *Securities rates* |
| Bono thesari 1/ | | | | | | | Treasury bills 1/ |
| 3-M | - | - | - | 1.09 | 1.29 | 1.37 | 3-M |
| 6-M | - | - | - | - | 1.58 | 1.76 | 6-M |
| 12-M | 1.43 | 1.69 | 1.77 | 1.92 | 2.06 | 2.13 | 12-M |

**Burimi :** *Banka e Shqipërisë* **Source** *: Bank of Albania*

Tab - 4

**TREGUESIT FISKAL SIPAS BUXHETIT TË KONSOLIDUAR 2021**

Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2021

*Të dhëna progresive (Progresive Data)* — *në milionë Lekë (in million ALL)*

| Nr. | EMËRTIMI | Janar January | Shkurt February | Mars March | ITEMS |
|---|---|---|---|---|---|
| | **TOTALI TË ARDHURAVE** | **35,215** | **69,529** | **108,591** | **TOTAL REVENUE** |
| **I.** | **Të ardhura nga ndihmat** | **108** | **319** | **401** | **Grands** |
| **II.** | **Të ardhura tatimore** | **33,908** | **66,873** | **103,991** | **Tax Revenue** |
| **II.1** | **Nga Tatimet dhe Doganat** | **23,093** | **46,222** | **72,787** | **From tax offices and customs** |
| 1 | Tatimi mbi Vlerën e Shtuar | 11,205 | 21,630 | 31,742 | V.A. T |
| 2 | Tatimi mbi Fitimin | 1,553 | 3,713 | 10,579 | Profit Tax |
| 3 | Akcizat | 3,185 | 6,607 | 10,346 | Excise Tax |
| 4 | Tatimi mbi të Ardhurat Personale | 3,382 | 6,493 | 9,304 | Personal Income Tax |
| 5 | Taksa Nacionale dhe të tjera | 3,394 | 6,842 | 9,309 | National Taxes and others |
| 6 | Taksa Doganore | 375 | 938 | 1,506 | Customs Duties |
| **II.2** | **Të ardhura nga Pushteti Vendor** | **1,344** | **2,836** | **4,920** | **Revenues from Local Gov.** |
| 1 | Taksë mbi Pasurinë (ndërtesat) | 283 | 572 | 977 | Property Tax |
| 2 | Taksë mbi Biznesin e vogël | 2 | 10 | 83 | Small Business Tax |
| 3 | Taksa Lokale | 1,060 | 2,254 | 3,860 | Local Taxes |
| **II.3** | **Të ardh nga fondet speciale** | **9,470** | **17,816** | **26,284** | **Social ins. contributions** |
| 1 | Sigurimi Shoqeror | 8,127 | 15,285 | 22,587 | Social Insurance |
| 2 | Sigurimi Shëndetsor | 1,333 | 2,387 | 3,457 | Health insurance |
| 3 | Të ardhura për kompensim në vlerë të pronarëv | 11 | 144 | 240 | Compensation income in the value of owners |
| **III.** | **Të ardhura Jotatimore** | **1,200** | **2,337** | **4,199** | **Nontax Revenue** |
| 1 | Tran.Fitimi nga Banka e Shqipërisë | | | | Profit transfer from BOA |
| 2 | Të ardhura nga Inst.Buxhetore | 748 | 1,510 | 2,740 | Income of budgetary institutions |
| 3 | Tarifat shërbimeve | 193 | 323 | 676 | Utility fees |
| 4 | Të tjera | 259 | 504 | 780 | Others |
| | **TOTALI I SHPENZIMEVE** | **33,208** | **69,175** | **115,753** | **TOTAL EXPENDITURE** |
| **I.** | **Shpenzime Korrente** | **31,127** | **62,963** | **101,341** | **Current Expenditures** |
| **I.1** | **Personeli** | **6,421** | **13,212** | **20,188** | **Personnel expenditures** |
| 1 | Paga | 5,510 | 11,326 | 17,312 | Wages |
| 2 | Kontributi për Sigurime Shoqerore | 904 | 1,855 | 2,826 | Social insurance contributions |
| 3 | Arsimi I larte nga te ardhurat e veta | 6 | 31 | 50 | Higher education from its own income |
| **I.2** | **Interesat** | **4,547** | **6,922** | **9,671** | **Interest** |
| 1 | Të Brendshme | 3,509 | 5,304 | 7,497 | Domestic |
| 2 | Të Huaja | 1,038 | 1,618 | 2,174 | Foreign |
| **I.3** | **Shpenzime Operative Mirëmbajtje** | **2,366** | **5,440** | **10,486** | **Operational & Maintenance** |
| **I.4** | **Subvecionet** | **88** | **177** | **255** | **Subsidies** |
| **I.5** | **Shpenzime për fonde speciale** | **13,738** | **26,879** | **43,367** | **Social insurance outlays** |
| 1 | Sigurime Shoqerore | 10,493 | 20,812 | 31,480 | Social insurance |
| 2 | Sigurime Shëndetsore | 2,632 | 5,453 | 11,000 | Health insurance |
| 3 | Fondi I kompensimit të pronarëve | 613 | 613 | 887 | Owners' Compensation Fund |
| **I.6** | **Shpenzime per Buxhetin Vendor** | **2,466** | **6,530** | **10,754** | **Local budget expenditure** |
| **I.7** | **Shpenzime të tjera** | **1,503** | **3,803** | **6,619** | **Other expenditures** |
| 1 | Pagesa e Papunesisë | 84 | 175 | 281 | Unemployment insurance benefits |
| 2 | Ndihma Ekonomike | 1,219 | 3,176 | 5,493 | Economic Aid |
| 3 | Bonusi I lindjeve | 200 | 400 | 700 | Birth bonus |
| **I.8** | **Transferime Kapitale** | | | | **Capital transfers** |
| **II** | **Fondi Rezerve, Kontigjenca** | **92** | **137** | **189** | **Reserve fund/contigency** |
| **III** | **Shpenzime Kapitale** | **1,983** | **5,168** | **11,269** | **Capital expenditures** |
| 1 | Financimi Brendshëm | | 2,756 | 7,656 | Domestically financing |
| 2 | Investime nga te ardhurat e Arsimit te Larte | | 39 | 64 | From higer education system's own revenues |
| 3 | Financimi Huaj | 1,983 | 2,372 | 3,548 | Foreign financed |
| **IV** | **Fondi i rindertimit** | **6** | **907** | **2,955** | **Reconstruction fund** |
| **V.** | **DEFICITI** | **2,007** | **354** | **-7,162** | **CASH BALANCE** |
| **V.1** | **FINANCIMI DEFICITIT** | **-2,007** | **-354** | **7,162** | **CASH BALANCE FINANCING** |
| **V.2** | **Brendshëm** | **-2,780** | **1,326** | **-9,278** | **Domestic** |
| 1 | Të ardhura nga privatizimi | 17 | 20 | 25 | Privatization receipts |
| 2 | Hua-marrje e brendshme | 7,460 | 9,527 | 17,298 | Domestic new borrowing (net) |
| 3 | Të tjera | -10,257 | -8,222 | -26,600 | Others |
| **V.3** | **I huaj** | **773** | **-1,680** | **16,439** | **Foreign** |
| 1 | Hua afatgjatë(e marrë) | 1,665 | 1,757 | 3,162 | Long-term foreign borrowing (gross) |
| 2 | Ndryshimi i gjendjes së arkes* | 352 | 433 | 155 | Chang. of stat. Account |
| 3 | Ripagesat | -1,245 | -3,880 | -6,279 | Repayments |
| 4 | Mbështetje Buxhetore | | | 19,401 | Budgetary Support |

***Burimi*** *: Ministria e Financave dhe Ekonomisë* — ***Source*** *: Ministry of Finance and Economy*

Tab - 5

**Tabela e investimeve 2021**

*Table of investments 2021*

*Të dhëna progresive (Progresive Data)* *në milionë Lekë ( in million ALL)*

| | Janar<br>January | Shkurt<br>February | Mars<br>March | |
|---|---|---|---|---|
| **Financim i brendshëm** | - 2,780 | 1,326 | - 9,278 | **Domestic financing** |
| *Në %* | 138.5 | -374.5 | -129.5 | *In %* |
| **Financim i huaj** | 773 | - 1,680 | 16,439 | **Foreign financing** |
| *Në %* | -38.5 | 474.5 | 229.5 | *In %* |
| **Totali** | -2,007 | -354 | 7,162 | **Total** |
| *Në %* | 100 | 100 | 100 | *In %* |

**Burimi**: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

**Source**: Ministry of Finance and Economy

## Tab - 6 TË ARDHURAT DOGANORE DHE TATIMORE 2021
## CUSTOMS AND TAX REVENUES 2021

*Të dhëna progresive (Progresive Data)* *në milionë Lekë ( in million ALL)*

| | Janar<br>January | Shkurt<br>February | Mars<br>March | |
|---|---|---|---|---|
| Taksë doganore | 375 | 879 | 1,447 | Customs Duties |
| TVSH | 7,683 | 16,013 | 25,971 | V.A.T |
| Akcizë | 3,185 | 6,536 | 10,275 | Excises |
| Të tjera (Renta Minerare) | 247 | 466 | 653 | Others (Mineral Rent) |
